



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Me qëllim të zhvillimit, avancimit, dhe promovimit të krijimtarisë teatrore, dhe në pajtim me Rregulloren për ndarjen e Çmimeve për Teatër, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

**Për Çmimet që i ndanë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
në fushën e Teatrit për vitin 2024**

Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore dhe Çmimet vjetore për Teatër që u jepet krijuesve të dalluar në fushën e Teatrit.

Çmimi kombëtar për Vepër Jetësore

Çmimi u ndahet personaliteteve të shquara të fushës së Teatrit për suksesin, të arriturat gjatë karrierës, risitë dhe kontributin e veçantë në avancimin e Teatrit. Çmimi mund të jepet edhe pas vdekjes së autorit.

Çmimet Vjetore për Teatër për vitin 2024

1. Çmimi Vjetor për shfaqjen më të mirë

Çmimi ndahet për shfaqjen që ka pasur sukses të jashtëzakonshëm për nga vlerat, profesionalizmi, shikueshmëria dhe sukcesi në prezantim kombëtar, gjatë vitit paraprak.

2. Çmimi Vjetor për regjinë më të mirë

Çmimi i ndahet regjisorit për regjinë origjinale dhe kreative, në vitin paraprak.

3. Çmimi Vjetor për aktorin/aktoren më të mirë

Çmimi i ndahet aktorit/aktores më të mirë për performancë të shkëlqyeshme gjatë vitit paraprak, me një rol ose me disa role teatrore.

4. Çmimi Vjetor për prezantim të suksesshëm ndërkombëtar
Çmimi i ndahet produksioneve teatrore (Teatrove) ose regjisorit, aktorit, dramaturgut, skenografit apo krijuesit për performancën dhe suksesin në prezantim ndërkombëtar për vitin paraprak.

Çmimet u ndahen vetëm shtetasve të Republikës së Kosovës.

Në Konkursin e Çmimeve për Teatër mund të konkurrohet personalisht ose nëpërmjet propozimeve nga:

1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
2. Teatrot Publike
3. Teatrot Private
4. Fakultetet e Arteve të Universiteteve Publike dhe Private të Republikës së Kosovës
5. Shoqatat teatrore, kompanitë teatrore, trupat teatrore

Propozuesit mund të bëjnë vetëm nga një nominim për secilën kategori.

Vlerësimin për ndarjen e Çmimeve e bën Juria Profesionale e përbërë nga pesë (5) anëtarë.

Propozimi duhet të përmbajë: arsyetimin me shkrim, CV e të nominuarit dhe materialet e tjera përcjellëse audio-vizuele për të nominuarin.

Propozimi duhet të firmoset nga titullari i Institucionit/ Asociacionit që ka të drejtën e propozimit apo nga individit.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga data e shpalljes publike.

Propozimet dërgohen në Arkivin e MKRS-së, për Departamentin e Kulturës, në Zyrën nr. 022 (Adresa: MKRS, 10000 Prishtinë, Rruga "Nëna Terezë" nr. 35):

Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Prishtinë, 21.01.2025